

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S.M., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, duke vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë P.nr.177/2016 të datës 07.04.2017 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.646/2017 të datës 18.07.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me 14.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S.M., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë P.nr.177/2016 të datës 07.04.2017 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.646/2017 të datës 18.07.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me aktgjykimin P.nr.177/2016 të datës 07.04.2017, të dënuarin S.M., e ka shpallur fajtor për veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 i KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që i dënuari brenda afatit prej 2 (dy) vite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) €, kurse i dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.646/2017 të datës 18.07.2017, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit S.M., av. T.R., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtresën e evidentuar KMLP.II.nr.170/2017 e datës 21.09.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se në aktgjykimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, gabimisht është aplikuar ligji penal, meqë pretendohet se në veprimet e të dënuarit nuk formësohen elementet e veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së. Forma themelore e kryerjes së veprës penale pengimit të personit zyrtar, ka paraparë përdorimin e forcës dhe detyrën zyrtare që duhet të realizohen në mënyrë kumulative e në rastin konkret forca nuk është përdorë fare përkatësisht ka munguar me rastin e heqjes së shiritit edhe pse nuk e konteston faktin se i dënuari ka hequr shiritin e vendosur për fillimin e punimeve. Po ashtu në kërkesë nuk kontestohet fakti se kryetari i Komunës së Klinës kishte cilësinë e personit zyrtar, por pretendohet se prerja e shiritit nuk hyn në kuadrin e detyrave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale apo Statutin e Komunës së Klinës, pasi që prerja e shiritit paraqet akt ceremonial dhe shiriti mund të prehej edhe nga persona tjerë që nuk kanë cilësinë e personit zyrtar.

Më tutje në kërkesë, pretendohet se ekzistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, konkretisht nga dispozita e nenit 248 par.1 të KPPK-së, se pranimi i fajësisë nuk është bërë në harmoni me kriteret e përcaktuara, se pranimi i fajësisë nuk është

mbështetur në faktet e çështjes, aktakuza përmban shkelje të qarta ligjore dhe gabime faktike e po ashtu, pranimi i fajësisë nuk është bërë vullnetarisht dhe i dënuari nuk ka pasur konsultime me mbrojtësin e tij, pasi që nuk ka pasur fare mbrojtës. Pretendohet se kriteret për pranimin e fajësisë, nuk janë plotësuar, pasi që pranimi i fajësisë nuk mbështetet në prova konkrete, dëshmi të dëshmitarëve, që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale dhe për këto arsye gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur ta refuzoj pranimin e fajësisë. Më tutje thuhet se nuk janë plotësuar kushtet sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPK-së, bazuar edhe në faktin se i dënuari nuk ka pasur mbrojtës gjatë shqyrtimit fillestar edhe pse për këtë vepër penale nuk parashihet mbrojtja e obliguar, megjithatë duke u bazuar në faktin se i dënuari nuk është jurist, nuk ka qenë në njohuri se po e pranon një vepër penale, por ka pranuar gjendjen faktike, mirëpo, jo edhe gjendjen juridike, përkatësisht nuk ka mundur ta di se veprimi i tij paraqet vepër penale. Po ashtu pranimi i fajësisë duhet të jetë pranim vullnetar e nuk guxon të jetë si pasojë e kërcënimit, shtrëngimit, mosdijes, sëmundjes së përhershme ose të përkohshme psikike të të dënuarit.

Në kërkesë po ashtu pretendohet se edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk janë arsyetuar pretendimet ankimore, por vetëm janë dhënë arsye sipërfaqësore dhe jo të plota.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës penale dhe ka konstatuar se në rastet kur bëhet pranimi i fajësisë nuk nxjerrën dhe nuk administrohen prova, mirëpo, bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës e të cilat janë propozuar nga ana e Prokurorit të Shtetit për tu administruar, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar

në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të datës 29.03.2017 dhe është aprovuar pranimi i fajësisë dhe me këtë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit. Nuk është kontestues se në rastin konkret është përdorë forca dhe është hequr shiriti nga i dënuari i cili shirit ka qenë i vendosur për tu prerë me rastin e fillimit të punimeve për rregullimin e rrugës "Abedin Rexha" në qytetin e Klinës dhe atë para fillimit të ceremonisë së prerjes së shiritit për fillimin e punimeve në prezencë të kryetarit dhe nënkryetarit të Komunës së Klinës, asamblistëve dhe mysafirëve që ishin pjesëmarrës në këtë ceremoni. Qëndron fakti se shiriti i përrurimit të punimeve mund të ishte prerë edhe nga ndonjë person tjetër që mund të mos e kishte cilësinë e personit zyrtar, por në këtë rast ishte përcaktuar se shiritin e punimeve do ta prente kryetari i Komunës e për më tepër edhe pse decidivisht nuk është përcaktuar si kompetencë e kryetarit prerja e shiritit, por në vështrim të përgjithshëm kjo është e qartë se kryetari i komunës kishte kompetencë për prerjen e shiritit dhe përrurimin e fillimit të punimeve, siç është përcaktuar në nenin 58 par.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, se "...kryetari i komunës përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj...".

Kurse në pjesën tjetër të kërkesës, pretendohet se nuk janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 248 të KPPK-së. Mirëpo këto pretendime nuk qëndrojnë, për faktin se i dënuari, ka bërë pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 248 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është aprovuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë është konstatuar se pranimi i fajësisë është bërë pas deklarimit të të dënuarit dhe marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit e pastaj konstatimit se pranimi i fajësisë përkon plotësisht me kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 248 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pranimin e fajësisë si të bazuar, me bindje të plotë se i dënuari pranimin e fajësisë e ka bërë në bazë të deklarimit të lirë pa kurrfarë presioni, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, është e qartë se pranimi i fajësisë është në përputhje me kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së, për më tepër pranimi i fajësisë është në harmoni me provat e propozuara në aktakuzë, kurse përkitazi me të drejtën

për mbrojtës i dënuari është njoftuar, sipas procesverbalit të shqyrtimit fillestar të datës 29.03.2017, për të drejtën që mund të angazhoj “mbrojtës sipas zgjedhjes së tij” e me këtë njoftim ka përfunduar detyrimi i gjykatës, meqë në rastin konkret nuk parashihet mbrojtja e detyruar sipas dispozitës së nenit 57 të KPPK-së, e që do ta detyronte gjykatën e shkallës së parë të caktoj mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi se i dënuari nuk ka kuptuar se bëhet fjalë për vepër penale po ashtu nuk është i qëndrueshëm përkundër faktit se ai nuk është me profesion jurist, por megjithatë bazuar në të dhënat e tij personale, konstatohet se i njëjti ka të kryer fakultetin e komunikacionit dhe po ashtu ushtron edhe funksionin e asamblistit në Kuvendin Komunal në Klinë dhe me këto mund të konstatohet se megjithatë i dënuari posedonte njohuri të mjaftueshme për të kuptuar se veprimet e tij paraqesin vepër penale. Po ashtu duhet përjashtuar edhe pretendimet tjera siç potencohen në kërkesë siç janë *”kërcënimi, shtrëngimi, mosdija, sëmundja e përhershme ose e përkohshme psiqike”*, e që asnjë nga këto pohime nuk qëndrojnë, duke pasur parasysh se nuk është paraqitur asnjë e dhënë konkrete nga ana e mbrojtësit të të dënuarit me rastin e paraqitjes së ankesës dhe as me rastin e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, se ndaj të dënuarit është përdorur dhunë apo kërcënim.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.245/2017, më datë 14.03.2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka